



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 94 Datë 27.10.2009

PËR

**Miratimin e fondit prej 90 000 lekë për zhvillimin e veprimtarive festive me rastin e 65-vjetorit të Çlirimit të Korçës në 24 tetor 2009**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatoret Donatoret "Për miratimin e fondit prej 90 000 lekë për zhvillimin e veprimtarive festive me rastin e 65-vjetorit të Çlirimit të Korçës në 24 tetor 2009", në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrise se Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondit total prej 90 000 lekë për zhvillimin e veprimtarive festive me rastin e 24-tetorit, dites se çlirimit dhe 65-vjetorit të kësaj dite sipas strukture buxhetore vijuese:

1. Ftesa 300 cope x 50 lek	15 000 lek
2. Baner 1.10m x 2m	5 000 lek
3. Koktejl	70 000 lek
<b>TOTAL</b>	<b>90 000 lek</b>

2. Ky fond do të perballohet me shumën prej 90 000 lekësh nga fondi rezerve i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	04980	05	Art	6090000	- 90 000
Shtohet	00	01110	05	Art	6020000	+ 90 000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatoret, Drejtoria e Burimeve Njerezore.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Gjergji PENDAVINJI**